




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT
PROKURORIAL TË
KOSOVËS 2024**



Prishtinë, 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicionin pasqyrohen aktivitetet e KPK-
së për muajin gusht të vitit 2024)

Mbahet Takimi i 251-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 1 gusht 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 251-të, në të cilin diskutoi dhe miratoi pikat sipas rendit të ditës.



Të gjitha vendimet që u morën në këtë takim janë si në vijim, me ç’rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

- Themeloi Panelin Hetimor ndaj dy (2) prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Prizren;
- Miratoi Raportin e Grupit punues për shtesat e anëtarëve të KPK-së dhe angazhimin e anëtarëve jo prokurorë nëpër komisione, së bashku me rekomandime, me ç’rast do të themelohen dy komisione të përhershme;
- Miratoi Raportin vjetor për zbatimin e Planit Strategjik për vitin 2023;
- Formoi Grupit punues për hartimin e Planit Strategjik 2025-2027 dhe
- Miratoi katër (4) raporte përfundimtare të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për Grupin I, II dhe një prokuror të Grupit IV, si dhe Raportin përfundimtar të vlerësimit të parregullt për një prokuror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 8 gusht 2024 - Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së dhe përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Kosovë.



Gjatë këtij takimi, është diskutuar për inkorporimin e rekomandimeve të Këshillit Prokurorial, për mundësinë e angazhimit të anëtarëve jo prokuror në Komisionet e KPK-së, si dhe, për rishikimin e skemës së kompensimit të anëtarëve të KPK-së në Rregulloret përkatëse.

Pjesë e diskutimeve ishte edhe finalizimi i Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e stafit administrative në sistemin prokurorial, një hap i rëndësishëm për menaxhimin e karrierës dhe zhvillimin profesional të stafit.

Për më tepër, u bë plotësim ndryshimi i vendimit të Komisionit për Çështje Normative për Themelimin e Grupit Punues për Draftimin e Rregullores për Themelimin e grupeve të përbashkëta hetimore, me qëllim të rregullimit, funksionimit dhe koordinimit të hetimeve ndërmjet institucioneve të ndryshme.



Finalizohet drafti i Rregullores për Transferimin dhe Avancimin e Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial

Prishtinë, 15 gusht 2024 - Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së dhe përfaqësuesit e BE-së në Kosovë.

Gjatë këtij takimi, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative, kanë finalizuar Rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Stafit Administrativ në sistemin prokurorial, e cila përcakton rregullat dhe procedurat për transferim të përkohshëm, të përhershëm, transferim në rast të riorganizimit si dhe për avancimin e nëpunësve civil në administrativ e sistemit prokurorial.



Komisioni për Çështje Normative, Rregulloren e lartcekur do ta propozojë për miratim në KPK



Mbahet Takimi i 252-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 27 gusht 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 252-të me radhë, në të cilin diskutoi dhe miratoi pikat sipas rendit të ditës.

Vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si në vijim, me ç'rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:



- Miratoi dorëheqjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, z.Admir Shala dhe aprovoi kthimin e të njëjtit në detyrën e Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Speciale;
- Caktoi Prokurorin e Shtetit, z.Petrit Kryeziu, Ushtrues të Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren;
- Shqyrtoi kërkesën e Prokurorit të Shtetit, z.Arben Ismajli, për kundërshtimin e tij;
- Përditësoi një nga listat e prokurorëve të përzgjedhur për të shërbyer në panelet hetimore;
- Anëtarët e KPK-së u pajtuan që përfaqësuesit e saj të deleguar të marrin pjesë në punëtoritë dhe takimet e ndryshme për zbatimin e Deklaratës së Përbashkët të Zotimitit.

Mbahet punëtori për finalizimin e draftit të Rregullores për Zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive

Prishtinë, 28 gusht 2024 – Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, së bashku me Kryesuesin, Zëvendëskryesuesen, anëtarë të Këshillit Prokurorial, U.D. Kryeprokurorin e Shtetit, kryeprokurorë të prokurorive, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, prokurorë të prokurorive të vendit, Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së dhe përfaqësuesen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, janë duke mbajtur një punëtori dyditore në Tiranë.

Qëllimi i kësaj punëtorie është finalizimi i draftit të Rregullores për Zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve dhe Udhëheqësve të Departamenteve të Prokurorive të Republikës së Kosovës.

Që në fillim, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, potencuan rëndësinë e madhe të kësaj rregulloreje, drafti i së cilës është hartuar në përputhje me standardet e larta ligjore.

Gjithashtu, edhe pjesëmarrës të tjerë të kësaj punëtorie, nënvizuan gjatë diskutimeve të tyre se, ky akti normativ do të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe integritetit të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorëve dhe udhëheqësve të departamenteve të prokurorive të vendit, duke e bërë atë më të besueshëm dhe të kuptueshëm për të gjitha palët e përfshira.

Drafti i kësaj rregulloreje është publikuar për dëgjim publik në faqen zyrtare të sistemit prokurorial dhe pas finalizimit të tij në këtë punëtori do të procedohet për miratimin në njërin në takimet e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

